



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

07.10.2013

Agjencia Kosovare e Privatizimit

NJOFTIM PËR MEDIA

Të mërkurën hapen oferta për Valën 59 të Privatizimit me 40 ndërmarrje të reja

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se të mërkurën, me datë 09 tetor 2013, në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve do të mbajë ceremoninë e hapjes së ofertave për Valën 59 të Privatizimit. Gjithsej 40 ndërmarrje të reja përmban kjo valë e privatizimit dhe të gjitha këto do të privatizohen përmes metodës spin-off i rregullt. Dorëzimi i ofertave nga ofertuesit do të bëhet duke filluar nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kurse hapja e ofertave do të bëhet që nga ora 12:30. Gjithë ceremonia e dorëzimit të ofertave nga ofertuesit, e hapjes së ofertave dhe shpallja e fituesve të përkohshëm do të bëhet në praninë e ofertuesve, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe përfaqësuesve të medieve, ndërsa Agjencia bënë transmetimin e drejtpërdrejt edhe në internet përmes ueb faqes zyrtare: www.pak-ks.org, duke mundësuar përcjelljen e ceremonisë edhe nga gjithë të interesuarit që s'janë prezent në sallë.

Në këtë Valë ishte paraparë të privatizohet edhe Ndërmarrja e Re "Bankos", në Komunën e Pejës dhe Ndërmarrja e Re "Ndërtesa Administrative dhe Restoranti", në Komunë e Deçanit. Por, me vendim të Agjencisë për çështje pronësore këto dy ndërmarrje sot janë tërhequr nga privatizimi përmes Valës 59. Agjencia do të njoftoj me kohë për vendimin e ardhshëm rreth privatizimit të këtyre dy ndërmarrjeve të reja.

Në vazhdim mund të gjeni të bashkangjitur listën e plotë të Ndermarrjeve për shitje përmes Vales 59 të privatizimit:

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Dush 2 Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 1177595m² (117ha 75ari dhe 95m²) në ZK Dush, Komuna Klinë.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Babaj i Bokës Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 129458m² (12ha 94ari 58m²) që shtrihet në Zonat Kadastrale Babaj i Bokës dhe Korenicë, Komuna Gjakovë.

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Ereniku Industria Depo në Zonën Industriale Prishtinë Sh.P.K. - përfshinë tokën me sipërfaqe 5938m² (59ari dhe 38m²) dhe kompleksin e ndërtesave të depos dhe zyrave me sipërfaqe të përafërt 1438m² në Zonën Industriale, Komuna Prishtinë. Sipas matjeve në terren, sipërfaqja e objekteve është 1691m².

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Lutogllavë Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 236282m² (23ha 62ari 82m²) në ZK Lutogllavë, Komuna Pejë.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Resnik Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 1079696m² (107ha 96ari 96m²) në ZK Dush, Komuna Klinë.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Kovargë Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 200745m² (20ha 7ari 45m²) në ZK Kovragë, Komuna Istog.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Dashinoc 1 Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 574218m² (57ha 42ari 18m²) në ZK Dashinoc, Komuna Deçan.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Dashinoc 2 Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 620556m² (62ha 5ari 56m²) në ZK Dashinoc, Komuna Deçan.

Ndërmarrja e Re Boksitet e Kosovës Kompleksi i Administratës në Volljakë Sh.P.K. - përfshinë kompleksin e objekteve me sipërfaqen e përgjithshme afërsisht 1562m² dhe tokën me sipërfaqe 38496m² (3ha, 84ari dhe 96m²) e cila gjendet në Zonën Kadastrale Volljakë në Komunën Klinë. Pjesë e tenderit janë edhe makinëritë dhe pajisjet në kuadër të kompleksit të tenderuar, duke përfshirë ndërtesën e transformatorit elektrik me dy transformatorët dhe linjen e përcuesit të tensionit të lartë elektrik.

Ndërmarrja e Re Tokë në Gramaçel Sh.P.K. - përfshinë tokën me sipërfaqe 756256m² (75ha 62ari 56m²), prej të cilës përafërsisht 22ha janë tokë bujqësore ndërsa pjesa tjetër e tokës është me shkurre/mal, e cila shtrihet në ZK Gramaçel, Komuna Deçan.

Ndërmarrja e Re EUP Inxhiniering Sh.P.K. - përfshinë objektin e administratës me sipërfaqe totale prej përafërsisht 1,424.17m². Objekti përbëhet prej tre kateve të cilët janë të ndërtuar përmbi një pjese të objektit të vjetër (objektit përcjellës), gjithashtu objektin përcjellës (objekti i vjetër) përdhese, bodrumi dhe garazhin. Objekti gjendet në Rr. Fehmi Agani nr. 35, afër "Kafeve të vogla" në Prishtinë. Nuk ka tokë që do të transferohet blerësit të ri.

Ndërmarrja e Re Mekanizimi Shitorja Prizren Sh.P.K. - përfshinë vetëm lokalit afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 105m² i cili gjendet në katin përdhës të një ndërtese shumëkatëshe të banimit në



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Sheshin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në qendër të Prizrenit. Nuk ka tokë që do ti transferohet blerësit të ri.

Ndërmarrja e Re Mekanizimi Shitorja Ferizaj Sh.P.K. - përfshinë vetëm lokalin afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 146.16m² i cili gjendet në katin përdhës të një ndërtese shumëkatëshe të banimit në Rr.Dëshmorët e Kombit, në qendër të Ferizajt. Nuk ka tokë që do ti transferohet blerësit të ri.

Ndërmarrja e Re Elan Thertorja me tokë në Vushtrri dhe Toka në Mihaliq SH.P.K. - përfshinë tokën dhe ndërtesën me sipërfaqe rreth 4345m² (43ari 45m²) me vendndodhje në Vushtrri afër Urës së Vjetër dhe tokën me sipërfaqe rreth 438626m² (43ha 86ari 26m²) në fshatin Mihaliq të Komunës së Vushtrrisë.

Ndërmarrja e Re Elan Tokë afër Thertores në Vushtrri dhe Toka në Gllavotin SH.P.K. - përfshinë tokën me sipërfaqen të përafërt prej 27522m² (2ha 75ari 22m²) me vendndodhje në Vushtrri afër Urës së Gurit si dhe tokën në fshatin Gllavotin me sipërfaqe rreth 100492m² (10ha 04ari 92m²).

Ndërmarrja e Re Elan Tokë me depo në Svaraçak Sh.P.K - përfshinë tokë dhe ndërtesë me sipërfaqe të përgjithshme prej 6893m² (68ari 93m²) sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL -70202029-0005, parcela 00353-0, me vendndodhje në fshatin Svaraçak të Komunës së Vushtrrisë, afër rrugës magjistrale Mitrovicë-Vushtrri-Prishtinë.

Ndërmarrja e Re Tokë në Kaçandoll SH.P.K. - përfshinë tokën me sipërfaqen e përgjithshme prej përafërsisht 239836m² (23ha 98ari 36m²) të përshkruara në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me numër -12-3940,Zona kadastrale Kaçandoll, Komuna e Mitrovicës.

Ndërmarrja e Re Agrokultura Tokë në Livoç Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 62485m² (6ha 24ari 85m²) në zonën kadastrale Livoç, në Komunën e Gjilanit. Prona është përdorur për kullosë.

Ndërmarrja e Re Agrokultura Tokë në Nasale Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 76585m² (7ha 65ari 85m²) në zonën kadastrale Nasale, Komuna e Gjilanit. Prona është përdorur për kullosë.

Ndërmarrja e Re Zhegra Tokë në Lladovë Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 10546m² (01ha 05ari 46m²) në zonën kadastrale Lladovë, Komuna e Gjilanit. Prona është përdorur për kultivimin e grurit dhe misrit.

Ndërmarrja e Re Zhivko Vasiç Tokë në Tomanc Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 332057m² (33ha 20ari 57m²) në zonën kadastrale Tomanc, Komuna Ranillug. Prona është përdorur për kultivimin e grurit dhe misrit.

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Agroprodukti Tokë në Koretin Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 196602m² (19ha 66ari 02m²) në zonën kadastrale Koretin, në Komunën e Kamenicës. Prona është përdorur për kultivimin e grurit dhe misrit.

Ndërmarrja e Re Agroprodukti Tokë në Muçivërc Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 57374m² (5ha 73ari 74m²) në zonën kadastrale Muçivërc, në Komunën e Kamenicës. Prona është përdorur për kultivimin e grurit dhe misrit.

Ndërmarrja e Re Agroprodukti Tokë në Dajkoc Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 24151m² (2ha 41ari 51m²) në zonën kadastrale Dajkoc, në Komunën e Kamenicës. Prona është përdorur për kultivimin e grurit dhe misrit.

Ndërmarrja e Re Agromorava Tokë në Gërmovë Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 96681m² (9ha 66ari 81m²) në zonën kadastrale Gërmovë, në Komunën e Vitisë. Prona është përdorur për kultivimin e grurit dhe misrit.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Binça 3 Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 749439m² (74ha 94ari 39m²) e cila është e regjistruar në parcelën nr. 1-1 të Certifikatës Pronësore nr. UL71006005-00108, ZK Binxhë, Komuna Klinë.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Siqevë Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 1250723m² (125ha 7ari 23m²) që shtrihet në gjashtë parcela tokë të regjistruara në Certifikatën e Pronësisë nr. UL-71006045-00134 në ZK Siqevë, Komuna Klinë.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Poterq i Epërm SH.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 1196079m² (119ha 60ari 79m²) e cila shtrihet në Zonat Kadastrale Poterq i Poshtëm dhe Poterq i Epërm në Komunën Klinë.

Ndërmarrja e Re Tokë bujqësore Rracaj Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 1083917m² (108ha 39ari 17m²) që shtrihet në Zonat Kadastrale Kusar/Kodra Hutit, Skivjan, Osek Hile dhe Rracaj në Komunën Gjakovë. Sipas certifikatave pronësore, rreth 49ha të këtij kompleksi evidentohen me kulturë mal.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Rastavicë D Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 70122m² (7ha 1ari 22m²) tokë bujqësore në ZK Rastavicë Komuna e Deçanit, më pak se 1km nga rruga rajonale Gjakovë-Pejë dhe afër rrugës për në Junik.

Ndërmarrja e Re KB Liria Tokë bujqësore Budisalc Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqe 81390m² (8ha 13ari 90m²) e cila shtrihet në Zonën Kadastrale Budisalc pranë lumit "Drini i Bardhë" në fsh. Budisalc, Komuna Klinë.

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Llapashticë e Epërme Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 23026m² (2ha 30ari 26m²) e cila gjendet në zonën kadastrale Llapashticë e Epërme, në Komunën e Podujevës. Ndërmarrja e Re gjendet në zonën kadastrale Llapashticë e Epërme 30 km larg kryeqendrës Prishtina përderisa 10km gjendet larg qytetit të Podujevës.

Ndërmarrja e Re Rekreators Sh.P.K.- përfshinë likalin afarist me sipërfaqen e përgjithshme prej 98m² e cila gjendet në katin përdhes të ndërtesës shumëkatëshe të banimit, në Sheshin Nënë Tereza P+8, afër ndërtesës së Rektoratit në Prishtinë.

Ndërmarrja e Re Tokë Radisheve Skenderaj Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 15ha 27are 32m² (152732m²) me lokacion në fshatin Radishevë, Komuna e Skenderajt.

Ndërmarrja e Re Depoja Frigoriferi Shillovë Sh.P.K. - përfshinë objekt njëkatësh 4322m² si dhe tokën përcjellëse 9878m², që së bashku përfshinë një sipërfaqe të përafërt prej 14200m² (1ha 42ari 00m²). Objekti i depos frigoriferi përbëhet nga 6 dhoma frigoriferi, me vëllim total prej 12880m³. Lokacioni është në fshatin Shillovë (në afërsi të qytetit të Gjilanit) mjaft i përshtatshëm për zhvillim të çdo lloj biznesi.

Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Gjylekarë Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 378232m² (37ha 82ari 32m²) e cila gjendet në afërsi të fshatit Gjylekar, Komuna e Vitisë.

Ndërmarrja e Re Industria e Mishit Agrokultura Sh.P.K. - përfshinë njësinë e Industrisë së Mishit e cila përfshin tokën me hapësirë prej 57239m² (5ha 72ari 39m²) në të cilën gjenden ndërtesat me hapësirë totale prej rreth 10815m² si dhe asete te tjera qe përbejnë: Linjën e therjes së shpezëve, me kapacitet 2500-3000 biba ose 8000 zogë pule në një ndërrim (8 orë pune); Repartin për përpunimin e mishit, sallameve, suxhuk, proshutë/mishra te thate, konserva te ndryshme dhe linja e hamburgerëve; Linja e therjes se kafshëve te trasha me kapacitet 40 frymë për një ndërrim pune; Linja e therjes së kafshëve të imëta, me kapacitet 600 qingja në një ndërrim; Fabrika për përpunimin e eshtrave dhe mbetjeve organike në prodhimin e koncentratit.

Ndërmarrja e Re Stacioni i Veterinarisë Shtërpçë Sh.P.K. - përfshinë tokën bujqësore me sipërfaqen e përgjithshme prej 876m² (8ari 76m²) ku brenda kësaj hapësire është i ndërtuar objekti një katësh me sipërfaqe të përafërt prej 183m². Vendndodhja është në qendër të Shtërpçës dhe është shumë atraktive për zhvillimin e çdo lloj të biznesit.

Ndërmarrja e Re Vreshtaria 2 - Tokë bujqësore Novakë Sh.P.K.- përfshinë tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej 129ha 75ari 61m² (1297561m²).

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ndërmarrja e Re Vreshtaria 1 - Tokë bujqësore Smaq Sh.P.K.- përfshinë tokën bujqësore (vreshta jo aktiv) me sipërfaqen e përgjithshme prej 18 ha 35ari 20m² (183520m²).

FUND

Rr. Ilir Konushevcu No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org